



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e  
Komuniteteve dhe Kthim**

**Legjislatura e III-të**  
**Nr. 03/08**  
**Prishtinë, më 15.04.2008, ora 13:00**  
**Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10**

**PROCESVERBAL**

nga mbledhja e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e  
Komuniteteve dhe Kthim

**Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Bojan Stojanović , Sanije Aliaj, Müfera Şinik, Kosara Nikolić, Sadik Idriz, Numan Balić, Hafize Hajdini, Hetem Arifi, Zylfi Merxha, Mursejl Haljilji, Enis Kervan, Xhevdet Neziraj.**

**Anëtarët jo të pranishëm: Zafir Berisha.**

Gjithashtu të pranishëm ishin: monitruues nga Zyra e Presidentit, OSCE, NDI, OHCHR.

Nga shërbimi i sekretarisë: Natasha Prica -Tisma, Arta Hajra, Vilson Ukaj, Dashurije Canolli.

**Kryesues: Bojan Stojanović, kryetar i komisionit.**

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës.**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. L-017/1 të Inspektoratit të Punës, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente;**

4. **Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit L-021/1 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie sociale, me amendamente;**
5. **Shqyrtimi i Projektligjit për taksën e vendosjes, me raportin e komisionit funksional – Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion, me amendamente;**
6. **Të ndryshme.**

**Kryetari** hapi mbledhjen duke i njoftuar anëtarët rreth takimit që kanë pasur kryetarët e komisioneve dhe shefat e grupeve parlamentare me Kryesinë e Kuvendit dhe rekomandimet që kanë rrjedhur nga ajo mbledhje për përshpejtimin e kryerjes së punëve që parashtrihen para komisioneve parlamentare. Theksoi se ka konstatuar se si komision kryesorë do të jenë efikas në kryerjen e këtyre obligimeve dhe detyrave, por duke pasur parasysh edhe realizimin e qëllimit të këtij komisioni që është mbrojtja e të drejtave dhe interesave të të gjithë komuniteteve që jetojnë në Kosovë.

Më pas kryetari propozoi rendin e ditës dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen për këtë rend dite.

**Sanije Aliaj** kërkoi që në pikën të ndryshme të diskutohet rreth jetësimit të planit të punës së komisionit të miratuar mbledhjen e kaluar. Konkretisht rreth vizitave nëpër komuna. Të fillohet me vizita në dy komuna, njëra të jetë Komuna e Mamushes, ndërsa për tjetrën të vendosin anëtarët e komisionit. Gjithashtu i njoftoi anëtarët se vërejtjet dhe propozimet e bëra rreth planit të punës janë inkorporuar në të, duke mos përjashtuar mundësin e kryerjes së aktiviteteve tjera që do ta bënin punën e komisionit më efikase.

Kryetari përkrahu propozimin znj. Sanije për plotësim në pikën të ndryshme dhe pas votimit të bërë konstatoi se rendi i ditës u miratua.

## **2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar**

Procesverbali nga mbledhja e kaluar dt. 19.03.2008, u miratua me vërejtjen z.Enis Kervan.

**Kryetari** kërkoi nga anëtarët të jenë efikas në punën e komisionit. Të dërgohen materialet 72 orë përpara mbledhjes në mënyrë që të ketë kohë të mjaftueshme për analizimin e tyre dhe të përgatitur të bëhen propozimet dhe amendamentet konkrete lidhur me qështjet që kanë të bëjnë me të drejta dhe interesat e komuniteteve. Të caktohen raportuesit për Projektligjet e veçanta për analizimin e tyre dhe pas raportimit, vërejtjet e arsyeshme të inkorporohen në rekomandimin tonë.

**Sanije Aliaj** theksoi se shumica e anëtarëve kanë qenë në mandatin e kaluar dhe e kanë të njohur procedurën e praktikuar nga komisioni. Para leximit të parë të Projektligjit është caktuar një raportues që ta analizojë atë dhe pastaj të jap vërejtjet dhe sugjerimet e tija lidhur me atë se a shkelin ato dispozita të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Kjo praktikë nuk ka dhënë rezultatet e duhura sepse ka shkaktuar një pasivitet të deputetët tjerë të cilët nuk kanë arritur ta kuptojnë esencën e tij. Propozoi që të shkohet sipas kësaj procedure: të bëhet leximi i parë në Kuvend, të marrin materialet e pastaj në mbledhjet e rregullta anëtarët të japin vërejtjet e tyre eventuale.

**Zylfi Merxha** u pajtua me propozimet e znj.Sanije lidhur me atë që anëtarët të punojnë individualisht në atë lëmi që e njohin dhe kanë përvojë profesionale pastaj në mbledhjet e komisionit të jepen vërejtjet konkrete lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

**Numan Balić** kërkoi që vazhdohet me praktiken e kaluar, që të caktohet një raportues për të bërë analizimin e Projektligjit dhe pastaj të raportoi në mbledhjet e rregullta të komisionit lidhur me dispozitat që kanë të bëjnë me të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

**Xhevdet Neziraj** lidhur me propozimet e procedimit të Projektligjeve, theksoi se praktika e kaluar me raportues nuk ka dhënë rezultate të kënaqshme, pasi që vet raportuesit nuk kanë qenë serioz. Duke pasur parasysh faktin se në të kaluarën shumica e Projektligjeve nuk kanë cenuar të drejtat e komuniteteve, mbështeti propozimin që anëtarët pas leximit të parë të Projektligjeve të marrin materialet të analizojnë ato dhe të japin vërejtjet eventuale. Por në rastet e kur konstatojmë se ndonjë Projektligj mund të prek interesat e komuniteteve mund të caktojmë edhe raportues.

**Sadik Idriz** mbështeti propozimet që Projektligjet të analizohen nga anëtarët veç e veç, pastaj të bëhen vërejtjet eventuale, kjo për shkak të pasivitetit që mund të shkaktohet dhe mundësia që shumë probleme të mos evidentohen. Në raste e veçanta të caktohen edhe raportues.

**Kryetari** theksoi se lidhur me shqyrtimin e Projektligjeve nga komisioni kemi dy propozime:

- Të punojmë në mënyrë individuale dhe
- Të punojmë me raportues.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve të bëra, Komisioni njëzëri nxori këtë:

## K O N K L U Z I O N

Komisioni përkrah propozimin që pas miratimit të Projektligjeve në lexim të parë të analizohen individualisht nga anëtarët dhe në mbledhjen të jepen vërejtjet lidhur me mundësin e cenimit të drejtave dhe interesave të komuniteteve. Ndërsa për Projektligjet të veçanta të caktohet raportues i cili do të raportoj në mbledhjet e komisionit.

### **3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. L-017/1 të Inspektoratit të Punës, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente**

**Kryetari** lidhur me pikën e tretë të rendit të ditës theksoi se ka biseduar me autoritete e Ministrisë përkatëse dhe ka marrë informatat nga ata se nuk janë të kënaqur me amendamentet e propozuara nga komisioni funksional dhe ka indikacione nga ata se do ta tërheqin Projektligjin nga procedura. Në vazhdim kërkoi nga anëtarët të japin vërejtjet e tyre eventuale lidhur me Projektligjin dhe amendamentet e komisionit funksional nëse kanë vërejtur se ato cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Kërkoi nga Z. Idriz si kryetar i komisionit funksional që ka propozuar amendamentet të jap sqarime më të hollësishme për këto amendamente.

**Sadik Idriz** lidhur me tërheqjen e Projektligjit nga sponzoruesi atë mund ta bëjë, por komisioni ka kryer punën e vet dhe ka propozuar amendamentet me qëllim që Ligji të jetë më i zbatueshëm. Problemi më kontradiktor ka mundur të shfaqet të krijimi i Agjensionit Ekzekutiv, ku komisioni ka vlerësuar se nuk ka nevojë që të krijohet për arsye se funksionet e saja do të ishin në shkallë më të lartë se të Inspektoratit, prandaj njëzëri ka votuar për ndryshimin e kësaj dispozite. Përndryshe nuk i cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pas sqarimeve të dhëna, me votimin e bërë Komisioni njëzëri nxori këtë:

## REKOMANDIM

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim përkrahu Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. L-017/1 të Inspektoratit të Punës dhe raportin e komisionit funksional–Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente, me konstatimin se nuk i cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit që në procedurë të mëtejme, ta miratojë atë.

### **4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit L-021/1 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie sociale, me amendamente**

**Kryetari** pas lexoi Projektligjin me raportin e komisionit funksional, kërkoi nga anëtarët të japin vërejtjet e tyre eventuale nëse mendojnë së Projektligji dhe amendamentet e propozuara cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Kërkoi nga z. Idriz si kryetari i komisionit funksional të jap sqarime për amendamentet e propozuara.

**Sadik Idriz** komisioni funksional ka propozuar amendamentet duke u mbështetur edhe në diskutimin e bërë në Parlament dhe qëllimi i tyre është garantimi i ndihmës së barabartë për të gjitha kategoritë që përfshihen në kuadër të skemës së ndihmës sociale. Përndryshe Projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pas sqarimeve të dhëna, me votimin e bërë Komisioni njëzëri nxori këtë:

## REKOMANDIM

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim përkrahu Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit L-021/1 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë dhe raportin e komisionit funksional - Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie sociale, me amendamente, me konstatimin se nuk i cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit që në procedurë të mëtejme, ta miratojë atë.

### **5. Shqyrtimi i Projektligjit për taksën e vendosjes, me raportin e komisionit funksional – Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion, me amendamente**

**Kryetari** pas lexoi Projektligjin me raportin e komisionit funksional, kërkoi nga anëtarët të japin vërejtjet e tyre eventuale nëse mendojnë së Projektligji dhe amendamentet e propozuara cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, me votimin e bërë Komisioni njëzëri nxori këtë:

## REKOMANDIM

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim përkrahu Projektligjin për taksën e vendosjes dhe raportin e komisionit funksional – Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion, me amendamente, me konstatimin se nuk i cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit që në procedurë të mëtejme, ta miratojë atë.

## 6. Të ndryshme

**Kryetari** u pajtua me propozimin e znj. Sanije për vizitat nëpër komuna, por për shkak të mungesës së tij propozoi që për këtë çështje të vendoset në mbledhjen e ardhshme që do të jetë më 29 prill.

**Numan Balić** lidhur me vizitat nëpër komuna, kërkoi një vizitë e tillë të bëhet edhe në Mëhallën e boshnjakëve në Mitrovicë dhe të vizitohet Komuna e Leposaviqit, kjo do të mund të bëhet në Qershor ashtu siç është paraparë në plan të punës. Nga vizitat të kërkohen rezultate konkrete.

**Sadik Idriz** lidhur me vizitën e planifikuar në Maqedoni, për shkak të situates politike atje, të shtyhet për një kohë tjetër. Vizitat nëpër komuna të afërta të bëhen në të njëjtën ditë, psh. në Lipjan dhe Janjevë. Po ashtu të vëhen kontakte me organizatat ndërkombëtare, si me: OSCE, UNDP.

**Sanije Aliaj** propozoi që të bëhen dy vizita në muaj. Të vizitohen kuvendet komunale, të vëhen kontaktet me komunitete që jetojnë atje dhe pas marrjes së informatave të hartojmë raport dhe me shkresë të iu drejtohem Ministrive përkatëse, pas kësaj të kërkojmë llogari rreth masave që kanë ndërmarrë në implemtimin e Ligjeve dhe përmisimin e kushteve të jetesës të komuniteteve që jetojnë atje. Kërkoj që të iu dërgohet një shkresë Kryetarit të Kuvendi, Zyres së Kryeministrit, Ministrisë për Komunitete, Ministrisë së Pushtetit Lokal që nëpërmes përfaqësuesve të vet të marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e komisionit. Po ashtu shkresa të tilla tu dërgohen edhe Ministrive tjera, që varësisht prej temave që diskutohen të marrin pjesë në punën e komisionit. Gjithashtu kërkoi të vëhen kontaktet me Ambasaden e Zvicres në Prishtinë për organizimin e vizites së premtuar atje me qëllim të shkëmbimit të përvojave institucionale ndërmjet dy vendeve.

**Müferra Şinik** propozoi që vizitat të bëhen në mënyrë të organizuar dhe me pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve e jo të ndarë në grupe.

**Enis Kervan** theksoi se ai ka propozuar vizitat në Janjevë, Lipjan dhe Gjilan dhe qëllimi është që të takohemi me komunitetet dhe autoritetet komunale dhe të njoftohemi me problemet që kanë dhe të shikohet se sa implementohen Ligjet, siq është Ligji për përdorimin e gjuhëve.

**Hete Arifi** lidhur me viziten në Janjevë, propozoi që të vizitohet Komuna e Lipjanit sepse në Janjevë funksionon vetëm Zyra e Ofiqarisë, përndryshe përfaqësuesit e komunitetit kroat i kanë vendet e rezervuara në Zyren për komunitete dhe aty mund të takohemi dhe bisedojmë për problemet e tyre.

**Xhevdet Neziraj** kërkoi që mos të bëhen vizita të shumta por kualitative. Të përgatitet vizita, pas marrejs së informacioneve të bëhet raporti në Ministrinë përkatëse dhe të kërkohet llogari për përmisimin e gjendjes atje. Të mos ndodh si mandatin e kaluar siç ishte rasti i vizites së Kolonisë së Gjakoves ku autoritetet kompetente pas alarimit nga ne, e kanë vizituar vendin dhe kanë premtuar se do të iu ndihmojnë atyre njerëzve e në realitet nuk kanë ndërmarrë asgjë.

**Kosara Nikolić** kërkoi që të marrin raportet rreth vizitave që janë bërë në mandatet e kaluara dhe rezultateve që janë arritur atje, në mënyrë që tani të shkojmë në një vend tjetër dhe të shihet se po ndërmerret dhe po bëhet diçka.

**Mursejl Haljilji** propozoi që komisioni të vizitojë disa komuna por që ato vizita të jenë të suksesshme, të kërkohet nga Institucionet kompetente që të zgjidhen problemet që mund të i hasim atje. Pas kërkesës sonë të shkojmë prapë në të njëjtën komunë për të parë se sa janë arritur rezultatet.

**Sanije Aliaj** kërkoi të respektohen objektivat kryesore të komisionit tashmë të precizuara në planin e punës. Obligimi i komisionit është senzibilizimi i institucioneve për ndërmarrjen e masave në

drejtimi të përmisimit të jetës të të gjithë komuniteteve dhe integritit të tyre në strukturat komunale dhe institucionet tjera publike dhe në implemetimin e Ligjeve që kanë të bëjnë më komunitetet. Ky është roli dhe mundësia që mund të bëjë Komisioni.

**Kryetari** lidhur me vizitën në Zvicër theksoi se është në kontakt me OSCE për mënyrën e organizimit dhe do të bëhet shkresa Ambasadës Zvicerane. Rreth vizitave nëpër komuna duhet që ato të jenë cilësore dhe praktike, të përgatiten nga anëtarët e komisionit që i përkasin komunitetit që do ta vizitojmë në bashkëpunim me udhëheqjen komunale dhe pas vizitave të kërkohet llogari nga Institucionet përkatëse për ndremarrjen e masave konkrete në drejtim të përmisimit të kushteve të jetesës të të gjithë komuniteteve. Lidhur me vizitën në Mitrovicë të propozuar nga z. Balic, për momentin nuk janë kushtet e favorshme por në të ardhmen do të realizohet edhe kjo vizitë. Po ashtu u pajtua se do duhej dhe do të iu dërgohen shkresa Ministrive përkatëse që ta përcjellin punën e komisionit.

Mbledhja përfundoi në ora 14:05

**Kryetari i Komisionit**

Shërbimi i komisioneve

**Bojan STOJANOVIQ**

Mbledhja e radhes u caktua më 29 prill 2008

